



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.17, datë 26.04.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“NDËRTIMI I “HEC DOHOSHISHT”, NË PELLGUN UJËMBLEDHËS TË PËRROIT TË PESHKOPI SË, PRANË FSHATIT DOHOSHISHT, BASHKIA DIBËR, QARKU DIBËR”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “General Green Energy” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i “Hec Dohoshisht”, në pellgun ujëmbledhës të përroit të Peshkopisë, pranë fshatit Dohoshisht, Bashkia Dibër, Qarku Dibër”, me zhvillues shoqërinë “General Green Energy” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Dibër.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

A large, stylized handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRIE', 'MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË', and 'TIRANË' around a central emblem.

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

A large, stylized handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRIE', 'AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT', and 'MINISTRIA' around a central emblem.